



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:230211
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876124

KPPP.nr.1721/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “ASTRONIK” SHPK, me NUI:810824145, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Sabri Ademi, me seli në Prishtinë, rr. “Zenel Salihu” nr.65, kundër debitorit “The North Unicorn L.L.C”, me NUI:810112186, me seli në adresën rr.”Muharrem Fejza” Royal – Prishtinë duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.351/23 të datës 28.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Nuhiu me seli të zyrës në Gjilan, jashtë seancës, me datë 26.06.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “The North Unicorn L.L.C”, ashtu që Urdhri P.nr.351/23 i datës 28.08.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Nuhiu MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.351/23 të datës 28.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.2293 e datës 29.12.2022, faturës nr.137/23 e datës 25.01.2023, faturës nr.178/23 e datës 31.01.2023, faturës 390/23 e datës 28.02.2023, faturës 612/23 e datës 31.03.2023, faturës 793/23 e datës 29.04.2023, faturës 1021/23 e datës 31.05.2023, faturës 1204/23 e datës 30.06.2023 dhe faturës 1550/23 e datës 22.08.2023 duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrit, t'ia paguajë kreditorit borxhin 1,613.97 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas tarifës së përmbaruesve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se propozimin për përmbarim e karakterizon parregullsia në përmbajtjen e tij, kemi parasysh faktin se propozimi për përmbarim mbështetet në fatura të cilat nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar nga ana e debitorit, si dhe vulën e debitorit me çka ndër të tjera cenon rëndë kredibilitetin dhe bazën ligjore të këtij urdhri përmbarues. Tutje debitori thekson se për fatura tjera të pranuar dhe për borxhin e njoftuar në mënyrë të rregullt, debitori i ka kryer në vazhdimësi pagesat. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar Prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj në tërësi Urdhrin Përmbarimor P.nr.351/23.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit sepse vërehet qartë se prapësimi nuk ka bazë ligjore por qëllimi i tij i vetëm është shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit. Tutje Kreditori ka vazhduar të kërkoj nga debitori pagesën e borxhit dhe të mos tentoj që ta prolongoj më shumë këtë çështje . Kreditori ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të vërtetoj Urdhrin Përmbarimor P.nr.351/23.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme: faturës nr.2293 e datës 29.12.2022, faturës nr.137/23 e datës 25.01.2023, faturës nr.178/23 e datës 31.01.2023, faturës 390/23 e datës 28.02.2023, faturës 612/23 e datës 31.03.2023, faturës 793/23 e datës 29.04.2023, faturës 1021/23 e datës 31.05.2023, faturës 1204/23 e datës 30.06.2023 dhe faturës 1550/23 e datës 22.08.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimin të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij

aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1721/23, me datë 26.06.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.